



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK ✓

Nr. 7008 Prot

Shkodër, më 01.04.2025

Lënda: Dërgohet projektvendim dhe relacion

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR,

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur ju dërgojmë projektvendimin dhe relacionin :

**“PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT “MBËSHTETJE PËR
ZHVILLIM 2025-2026 PROJEKTI “BASHKI TË FORTA”-BASHKIA SHKODËR”.**

Duke Ju falënderuar,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2025

PROJEKT VENDIM

NR. _____, DATË _____._____.2025

**“PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT “MBËSHTETJE PËR
ZHVILLIM 2025-2026 PROJEKTI “BASHKI TË FORTA”-BASHKIA SHKODËR”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e datës ____04. 2025, me propozim të Kryetarit të Këshillit Bashkiak Shkodër, në mbështetje të ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, ligjit Nr.114/2024 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim Dhe Bashkëpunim, që Vepron Përmes Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për Projektin “Bashki të Forta (Btf), Faza 2”, si edhe Vendimit Nr.60 datë 28.12.2020 “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak Shkodër,

VENDOSI:

1. Të miratojë Memorandumin e Bashkëpunimit “Mbështetje për zhvillim 2025-2026, Projekti Bashki të Forta - Bashkia Shkodër,
2. Për zbatimin e këtij projekt vendimi, ngarkohet Kryetari i Këshillit dhe Kryetari i Bashkisë
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

SEKRETARE

Sabina Danaj

KRYETAR

Olion LULI



Adresa: Rr. “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. _____ prot.

Shkodër, më _____._____. 2025

RELACION

“PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT “MBËSHTETJE PËR ZHVILLIM 2025-2026 PROJEKTI “BASHKI TË FORTA”-BASHKIA SHKODËR”.

Faza e dytë e Projektit “Bashki të Forta” 2025-2026 vazhdon të ofrojë mbështetje dhe asistencë për Bashkinë Shkodër. Ky projekt, i cili është një përpjekje e rëndësishme për zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve të administratës vendore, ka për qëllim të përmirësojë shërbimet publike dhe të rrisë efikasitetin e menaxhimit të burimeve në nivel bashkie.

Partneri kryesor i projektit në nivel kombëtar është Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor (MSHPV), që vepron përmes Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV). MSHPV/AMVV koordinon aktivitetet dhe vendimmarrjen në kuadër të këtij projekti në bashkëpunim me Ministrinë e Financave (MF), si dhe me ministrinë dhe agjencitë përkatëse. Po ashtu, projekti bashkëpunon me shoqatat e njëjse të vetëqeverisjes vendore dhe mbulon 61 bashkitë e vendit.

Në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, dhe Ligjin Nr. 114/2024 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që vepron përmes Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për Projektin “Bashki të Forta” (BTF), Faza 2”, kërkohet miratimi i Memorandumit të Bashkëpunimit për periudhën 2025-2026. Ky memorandum ka për qëllim arritjen e disa objektivave strategjike, si më poshtë:

Objektivat e projektit:

1. **Përmirësimi i Shërbimeve Bashkiake:** Administratat bashkiake do të përmirësojnë ofrimin e shërbimeve, përfshirë menaxhimin e mbetjeve dhe arsimin parashkollor, duke e çuar ofrimin e këtyre shërbimeve drejt standardeve më të përshtatshme dhe më të përballueshme.
2. **Rritja e Kapaciteteve të Këshillave Bashkiakë:** Këshillat bashkiakë do të rrisin kapacitetet e tyre për të ushtruar mandatin e tyre në përputhje me ligjet dhe aktet

regullatore vendore, duke mbikëqyrur performancën e administratës bashkiake dhe angazhuar komunitetin në vendimmarrje të bazuar në të dhëna.

3. **Krijimi i Sistemit të Menaxhimit të Performancës Bashkiake:** Do të krijohet dhe funksionojë një sistem i ri menaxhimi të performancës bashkiake, si dhe një mekanizëm granti të bazuar në performancë, që do të mundësojë një vlerësim të saktë të aktiviteteve dhe rezultateve të arritura.
4. **Mbështetje për Kapacitetet e të Zgjedhurve Vendorë dhe Punonjësve të Administratës Bashkiake:** Projektin do të mbështesë financiarisht dhe në mënyrë të qëndrueshme rritjen e kapaciteteve, shkëmbimet dhe rrjetëzimin e të zgjedhurve vendorë dhe punonjësve të administratës bashkiake, duke përmirësuar kështu menaxhimin e shërbimeve dhe forcimin e lidhjeve midis bashkive.
5. **Përfshirja e Temave të Rëndësishme:** Bashkëpunimi me fokus në barazinë gjinore, përfshirjen sociale, ndryshimet klimatike, digjitalizimin, luftën kundër korrupsionit, si dhe bashkëpunimin me mediat, shoqërinë civile dhe institucionet e pavarura, do të jenë pjesë integrale në të gjithë komponentët e projektit.

Objektivi i Përgjithshëm:

Synimi i këtij projekti është të përmirësojë qeverisjen vendore dhe ofrimin e shërbimeve në nivel bashkie, duke siguruar që qytetarët të përfitojnë nga një administratë më e aftë dhe e përgjegjshme, me shërbime më të mira dhe më të qëndrueshme.


Përfundim:

Duke mbështetur këtë memorandum, synohet forcimi i kapaciteteve të administratës vendore dhe përmirësimi i shërbimeve të ofruara për qytetarët e Bashkisë Shkodër. Ky projekt është një mundësi për të rritur efikasitetin e bashkisë dhe për të siguruar që shërbimet publike të ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e qytetarëve, duke promovuar një qeverisje më të mirë dhe të përgjegjshme.

Bashkëlidhur: Draft i Memorandumit të Bashkëpunimit “Mbështetje për Zhvillim 2025-2026, Projekti “Bashki të Forta” - Bashkia Shkodër.

SEKRETARE

Sabina Danaj



KRYETAR

Oltion LULLI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Bashkia Shkodër



Nr. ____ .prot,

datë ____ . ____ . 2025

Nr. ____ .prot,

datë ____ . ____ . 2025

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Mbështetje për Zhvillim 2025-2026 Projekti 'Bashki të Forta'–Bashkia Shkodër

Ndërmjet

Bashki të Forta (BtF), një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe i Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation (Helvetas), përfaqësuar nga Norbert Pijls, Drejtor i Programit

dhe

Bashkisë Shkodër, në vijim NJQV, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Benet Beci

dhe Këshillit Bashkiak Shkodër, organi legjislativ i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore, në vijim KB, përfaqësuar nga Kryetari i Këshillit Z.Oltion Luli .



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige

1 HYRJE

1.1 Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor

Projekti “Bashki të Forta” (BtF) mbështet njësitë e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri, duke ofruar asistencë teknike dhe grante performancë me bashkëfinancim nga qeveria shqiptare. Gjatë periudhës 2025-2026, BtF synon të ofrojë asistencë intensive për 13 bashki model. Ky projekt është në përputhje me ligjin nr. 114/2024 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Përfaqësuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, Përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, e cila vepron përmes Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri për Projektin ‘Bashki të Forta (BtF), Faza 2’. Marrëveshja mbulon fazën e dytë të projektit deri më 30.09.2026.

1.2 Kuadri Ligjor

Baza ligjore për këtë Memorandum Bashkëpunimi është vullneti i shprehur në kuadër të një marrëveshjeje ndërmjet dy qeverive, të Konfederatës Zvicerane dhe Qeverisë së Shqipërisë, e ratifikuar me ligjin nr. 114/2024 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që vepron përmes Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për Projektin ‘Bashki të Forta (BtF), Faza 2’. Përveç kësaj, ky Memorandum mbështetet edhe nga Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

1.3 Dokumenti i Programit BtF

Elementet kryesore të Dokumentit të Programit BtF 2 dhe Planit Vjetor Operacional (PVO) 2025 janë hartuar në përputhje me pjesëmarrjen dhe miratimin e Komitetit Drejtues, i cili bashkëkryesohet nga Ministria e Shtetit për Pushtetin Vendor (MSHPV) dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). PVO e miratuar çdo vit shërben si një instrument i rëndësishëm për rregullimin e marrëdhënieve dhe aktiviteteve të përbashkëta brenda kuadrit të këtij memorandum bashkëpunimi.

1.4 Projekti BtF

Qëllimi kryesor i Projektit "Bashki të Forta" (BtF) është të sigurojë që qytetarët në Shqipëri të përfitojnë nga përmirësimi i qeverisjes dhe ofrimi i shërbimeve në nivel bashkie, sipas standardeve minimale dhe të përballueshme të dakordësuara për një sistem të qëndrueshëm kombëtar.

Veprimtaritë kryesore të përfshira në Dokumentin e Programit janë të organizuara në katër fusha pune:

1. **Përmirësimi i Shërbimit** – duke përfshirë menaxhimin e mbetjeve dhe arsimin parashkollor.
2. **Mbështetja për Mirëfunksionimin e Këshillit Bashkiak** dhe përmirësimi i komunikimit të tij me qytetarët.
3. **Menaxhimi i Performancës** – përfshirë grantin e performancës të bashkëfinancuar me qeverinë shqiptare.

4. **Rritja e Cilësisë së Njohurive dhe Rrjetëzimi i të Zgjedhurve Vendorë dhe Punonjësve të Bashkive** për të avancuar cilësinë e qeverisjes dhe shërbimeve bashkiake.

Dixhitalizimi dhe barazia sociale, si dhe gjithëpërfshirja, janë elementë të përbashkët dhe të integruar në të katër fushat kryesore të punës së Projektit "Bashki të Forta" (BtF).

1.5 **Memorandumi i Bashkëpunimit**

NJQV-ja e nënshkruar dhe projekti "Bashki të Forta" shprehin vullnetin dhe angazhimin e tyre për të bashkëpunuar në kuadrin e planit vjetor të punës, duke shkëmbyer informacion dhe përvojë në mënyrë aktive në fushat tematike të paracaktuara dhe të rëna dakord, sipas kërkesës dhe nevojave të NJQV-së.

2 **FUSHAT KRYESORE TË BASHKËPUNIMIT DHE MBËSHTETJES**

Fushat e bashkëpunimit dhe mbështetjes përfshijnë objektivat e mëposhtme:

- **Përmirësimi i administratave bashkiake** në ofrimin e shërbimeve, si menaxhimi i mbetjeve dhe arsimi parashkollor, drejt standardeve më të përshtatshme dhe të përballueshme për qytetarët.
- **Rritja e kapaciteteve të këshillave bashkiakë** për të ushtruar mandatin e tyre në përputhje me ligjet dhe aktet rregullatore vendore, duke mbikëqyrur efektivisht performancën e administratës bashkiake dhe angazhuar në vendimmarrje të bazuar në të dhëna dhe bashkëpunim me komunitetin.
- **Krijimi dhe funksionimi i një sistemi të ri të menaxhimit të performancës bashkiake** dhe një mekanizmi granti të bazuar në performancë, për të siguruar transparencë dhe efikasitet.
- **Mbështetje financiare dhe e qëndrueshme për bashkitë** për rritjen e kapaciteteve të të zgjedhurve vendorë dhe punonjësve të administratës bashkiake, përmes shkëmbimeve dhe rrjetëzimit.
- **Integrimi i çështjeve të gjinisë, përfshirjes sociale dhe ndryshimeve klimatike,** digjitalizimit, luftës kundër korrupsionit, bashkëpunimit me mediat, shoqërinë civile dhe institucionet e pavarura, si elementë kryesorë në të gjitha fushat e bashkëpunimit.



3 KONTRIBUTET DHE DETYRAT E BASHKISË PARTNERE DHE PROJEKTIT “BASHKI TË FORTA”

3.1 Pjesëmarrja dhe kontributi për veprimtaritë

Bashkëpunim dhe mbështetje aktive për të gjitha veprimtaritë e programit:

- Pjesëmarrja dhe bashkëfinancimi i përfaqësuesve/anëtarëve të stafit përkatës në takime, seminare, shkëmbime, trajnime, vizita studimore dhe aktivitete të tjera të organizuara në kuadër të Projektit BtF nga aktorë të sistemit të angazhuar në ngritjen e kapaciteteve dhe ndryshimet e politikave.
- Bashkëfinancimi i veprimtarive/projekteve, aty ku është rënë dakord.
- Lidhja në mënyrë aktive e të gjitha veprimtarive të projektit me ciklin e planifikimit, buxhetimit, zbatimit dhe raportimit të NJQV-së (planifikimi i burimeve njerëzore dhe financiare, procesi i planifikimit dhe buxhetimit të shërbimeve).
- Bashkëpunimi i ngushtë me koordinatorët rajonalë të projektit, krijimi i kushteve të bashkëpunimit për ta dhe dhënia e feedback-ut për performancën e tyre.

3.2 Anëtarësimi në rrjetet e lidërshiptit dhe ato tematike

Shkëmbimi në kuadër të rrjeteve të lidërshiptit dhe atyre tematike

- Kryetarët e bashkive, kryetarët e këshillave bashkiake, kryetarët e komisioneve të këshillave bashkiakë dhe punonjësit e bashkive/ekspertët tematikë vendorë të caktuar do të marrin pjesë rregullisht në rrjetet e drejtuesve/lidërshiptit dhe të ekspertëve ndërmjet NJQV-ve dhe do të zhvillojnë më tej kapacitetet dhe njohuritë e tyre të cilat do të përdoren për zbatimin e masave të përzgjedhura në përmirësimin e shërbimit (menaxhimi i mbetjeve dhe arsimi parashkollor), menaxhimin e performancës dhe veprimtarinë e këshillit bashkiak dhe në draftimin e politikave përkatëse.
- NJQV-ja u siguron përfaqësuesve të tyre burime të mjaftueshme për zbatimin e detyrave të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi , ndërkohë projekti “Bashki të Forta” do të mbështesë dhe asistojë zbatimin tematik të veprimtarive të rrjetit.

3.3 Kriteret për përfituesit e drejtpërdrejtë

NJQV-të mund të marrin mbështetje nga projekti “Bashki të Forta” duke:

- Shprehur interesin e tyre nëpërmjet nënshkrimit të këtij Memorandumi Bashkëpunimi;
- Marrë pjesë në skema të ndryshme të bazuara në performancë të ndërmarra nga qeveria shqiptare (si konkursi i praktikave të mira, grantet e performancës etj.)
- Marrë pjesë në platforma (p.sh. trajnime, konsultime etj.) të ndërmarra nga aktorët kombëtarë që mbështesin ngritjen e kapaciteteve, përmirësimin e politikave dhe përmirësimin e performancës.

3.4 Detyrat për Bashkinë dhe mbështetja e ofruar nëpërmjet Projektit “Bashki të Forta”

Për NJQV-në dhe për Projektin “Bashki të Forta” janë parashikuar këto detyra:

NJQV-ja zotohet të:	BtF ofron:
<i>Përmirësimi i Shërbimit (menaxhimi i mbetjeve dhe arsimit parashkollor)</i>	
Angazhohet për të punuar së bashku me NJQV-të e tjera për të përmirësuar shërbimet e ofruara, për të diskutuar dhe pilotuar standardet kombëtare të shërbimit në menaxhimin e mbetjeve dhe arsimin parashkollor, për të marrë pjesë në mënyrë aktive si anëtare e një prej shoqatave të qeverisjes vendore në vleftësimin e tyre dhe të zbatojë udhëzimet e nxjerra për këtë qëllim nga niveli kombëtar.	Asistencë logjistike dhe teknike, platformë diskutimi
Angazhojë koordinatorin e informimit të publikut/ departamentit të TI-së dhe shërbimeve (përfshirë mediat sociale dhe kanalet e internetit) për të hartuar, zbatuar, bashkëfinancuar dhe monitoruar fushatat me në qendër qytetarin.	Modelim, bashkëhartim dhe bashkëfinancim i fushatave
Ndërmarrë konsultimin/informimin publik sipas ligjit dhe rregulloreve të Këshillit Bashkiak për të gjitha inputet e nevojshme në dy shërbimet e përzgjedhura. (barazia gjinore; gjithëpërfshirja sociale)	Asistencë teknike për inputet e zgjedhura
Përzgjedhë masat sipas kërkesës dhe t'i zbatojë ato për përmirësime në shërbimet e menaxhimit të mbetjeve dhe arsimit parashkollor.	Trajnim, anëtarësim në rrjetin tematik, trajnim në punë
Planifikojë burimet/masat e paketës fiskale (nëse nevojitet) për të mbështetur masat e përzgjedhura për përmirësimin e shërbimit.	Asistencë teknike për të përcaktuar koston dhe tarifën e shërbimit
Marrë pjesë dhe mbështesë iniciativa për forcimin e transparencës, efikasitetit dhe masave kundër korrupsionit.	Rritje të ndërveprimit të administratës së bashkisë me Këshillin Bashkiak dhe komisionet e tij, në bashkëpunim me median, qytetarët dhe shoqërinë



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden

Sverige

NJQV-ja zotohet të:	BtF ofron:
	civile.
Sigurojë pjesëmarrjen e stafit në kurset përkatëse të trajnimit për menaxhimin e mbetjeve dhe arsimin parashkollor.	Bashkëfinancim, platformë diskutimi
<i>Menaxhimi i Performancës</i>	
Forcojë Njësinë e Performancës bazuar në udhëzimet e nxjerra për përmirësimin e të dhënave.	Asistencë teknike për Njësinë e Performancës përmes BtF-së dhe aktorëve të sistemit kombëtar; Ofrimi i një modeli të detyrave të NjP dhe rregullave të ndërveprimit me strukturat e tjera.
Hartimi, diskutimi dhe miratimi i raportit të performancës në Këshillin Bashkiak, duke siguruar që raporti të jetë i disponueshëm për publikun në mënyrë të qartë dhe të aksesueshme. Ky proces duhet të përfshijë përgatitjen dhe shqyrtimin e të dhënave të performancës vendore në përputhje me dispozitat ligjore të aktualizuara, për të garantuar transparencën dhe llogaridhënien ndaj qytetarëve..	Asistencë teknike për publikimin e raportit të performancës vendore nëpërmjet BtF dhe aktorëve të sistemit kombëtar. Nxitje e dialogut me median dhe shoqërinë civile mbi performancën vendore; ofrimi i mbështetjes për njësitë e performancës nëpërmjet koordinatorëve lokalë të projektit.
Pjesëmarrje aktive në ushtrimin e matjes së performancës gjatë ushtrimit që do të zhvillohet në vitin 2025, si dhe grumbullimi, analizimi e dorëzimi i të dhënave për hartimin e Raportit Kombëtar të Performancës së Bashkive	Mbështetje teknike për njësinë e performancës dhe strukturave të tjera në procesin e mbledhjes së të dhënave përmes udhëzimeve të detajuara, procedurave standarde dhe formularëve. Ofrimi i trajnimeve nëpërmjet ekspertizës së jashtme dhe aktorëve kombëtarë. Ofrimi i një platforme diskutimi, shkëmbimi i njohurive me NJQV-të e tjera.
Kontribuojë si anëtar i një prej shoqatave të qeverisjes vendore, në vleftësimin e një sistemi të menaxhimit të performancës duke ofruar mendimin e tyre për zhvillimin e skemës dhe modaliteteve të grantit për disa raunde radhazi.	Mbështetje për platformën e diskutimit për zbatimin e grantit përmes shoqatës, duke siguruar që zëri i bashkisë të dëgjohet në mënyrë efektive dhe të rregullt. Mbështetje teknike për bashkitë përmes AMVV-së në përgatitjen e dorëzimit të sistemit të GBP, duke ofruar udhëzime dhe asistencë praktike për implementimin e tij.

NJQV-ja zotohet të:	BtF ofron:
	Mbështetje për një kuadër rregullator të favorshëm për të bërë GBP të aksesueshme dhe të kuptueshme për të gjitha bashkitë, duke lehtësuar implementimin e këtij sistemi. Monitorimi i vlerësimit të bashkive për të siguruar trajtim të barabartë të aplikimeve dhe sigurimin e një procesi cilësor të ndarjes së fondeve, në përputhje me udhëzimet ligjore dhe standardet e përcaktuara.
Sigurojë pjesëmarrjen e stafit në kurset përkatëse të trajnimit për performancën.	Bashkëfinancim, platformë diskutimi, trajnime, duke pasur parasysh se pjesëmarrja në trajnime e stafit të NjP është një nga treguesit e GBP.
<i>Mbështetje për këshillin bashkiak</i>	
Këshilli Bashkiak ushtron mandatin e tij në përputhje me ligjin dhe rregulloret përkatëse. Ai ndërton ura komunikimi me qytetarët, duke luajtur me efektivitet rolin e tij si përfaqësues, vendimmarrës dhe mbikëqyrës.	Asistencë teknike të vazhdueshme, nëpërmjet ofruesve të shërbimeve, ekspertizës dhe koordinatorëve vendorë.
Këshilli Bashkiak ndërmerr nisma për rritjen e transparencës dhe realizon aktivitete për luftën kundër korrupsionit, në përputhje me strategjinë e qeverisë për këtë qëllim.	Asistencë teknike të zgjeruar, koordinim.
Përdorë pajisje për të transmetuar mbledhjet e Këshillit Bashkiak dhe për të monitoruar komentet e qytetarëve në përputhje me rregulloret e Këshillave Bashkiakë.	Pajisje dhe trajnim në punë. Asistencë teknike në raste të veçanta.
Publikojë regjistrat e ankesave, kërkesave dhe nismave të qytetarëve në faqen e internetit të bashkisë dhe t'i përditësojë ato rregullisht në përputhje me rregulloren.	
Hartojë, miratojë, zbatojë, monitorojë dhe	



NJQV-ja zotohet të:	BtF ofron:
raportojë planin vjetor të punës dhe buxhetin e këshillit, si dhe t’i vendosë ato (planin dhe raportimin) në dispozicion të publikut (theks i veçantë në procesin e konsultimit publik).	
Sigurojë mbështetje për Këshillin Bashkiak nëpërmjet koordinatorit të informimit të publikut dhe stafit të TIK-ut, të paktën duke përditësuar rregullisht faqen e internetit të Këshillit Bashkiak, duke përmirësuar kështu renditjen e barometrit të internetit.	
Ndërtojë procese/procedura të brendshme ndërmjet administratës dhe Këshillit Bashkiak bazuar në rregulloret/ligjet e Këshillit Bashkiak.	
Sigurojë që Këshilli Bashkiak të respektojë udhëzimet e AMVV-së në lidhje me kriteret për sekretaritë dhe sekretarët bashkiakë.	
Gjallërojë Komisionin e Barazisë Gjinore të Këshillit Bashkiak dhe Aleancën e Grave (përfshirë zgjedhjen e Aleancës Kombëtare të Grave) pas zgjedhjeve.	
Promovojë përfshirjen gjinore dhe sociale, veçanërisht në procesin e buxhetimit dhe advokojë për to në nivel kombëtar.	
Rritja e Kapaciteteve dhe Rrjetëzimi i të Zgjedhurve Vendorë dhe Punonjësve	
Garantojë pjesëmarrjen e nëpunësve bashkiakë (të zgjedhurit vendorë dhe punonjësit përkatës) në takime, seminare, shkëmbime, trajnime, vizita studimore dhe aktivitete të tjera të organizuara nga aktorë të sistemit të angazhuar në ngritjen e kapaciteteve dhe ndryshimet e politikave.	Platforma diskutimi të rrjeteve të të zgjedhurve dhe punonjëseve, si dhe mbështetje ndaj Akademisë për NJQV-të për rritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të bashkive.
Të garantojë planifikimin, përdorimin dhe raportimin vjetor të fondeve buxhetore për	Ofrimi i formateve (templates) dhe asistencës në vendin e punës për zyrtarët bashkiakë të angazhuar



NJQV-ja zotohet të:	BtF ofron:
aktivitetet trajnuese dhe zhvillimin e kapaciteteve të të zgjedhurve vendorë dhe punonjësve të bashkisë, duke siguruar gjithashtu transparencën e tyre, përfshirë edhe aktivitetet e trajnimit të mbështetura nga BtF.	në planifikimin, menaxhimin, raportimin vjetor dhe rritjen e transparencës së fondit buxhetor për trajnimet e të zgjedhurve vendorë dhe punonjësve të bashkisë
Kontribujë, si anëtare e Shoqatës për Autonominë Vendore, me pjesëmarrjen e zyrtarëve përkatës të bashkisë (të zgjedhurit vendorë dhe punonjësit) në shkëmbimet dhe rrjetëzimet mes kolegësh për të dokumentuar sfidat dhe propozuar zgjidhje, si dhe për të identifikuar dhe ndarë praktika të mira në qeverisjen vendore dhe ofrimin e shërbimit bashkiake.	Platformë diskutimi të rrjeteve të të zgjedhurve dhe punonjëseve, përmes shoqatave të QV-ve. Metodologji për identifikimin, dokumentimin dhe shpërndarjen e praktikave të mira.
Kontribujë, si anëtare e Shoqatës për Autonominë Vendore, në ndarjen e mjeteve/ produkteve (plane, rregullore, vendime, manuale, udhëzime, etj.) me bashki të tjera, për të mundësuar zgjerimin e njohurive teknike dhe praktike, ndarjen e praktikave dhe të produkteve mes bashkive dhe të mësuarit nga njëra tjetra; Kontribujë financiarisht në nisma për akademinë dhe mbulimin e kostove që lidhen me trajnimin e nëpunësve dhe të zgjedhurve vendorë.	Mbështetje për krijimin dhe popullimin e një Platforme të Menaxhimit të Njohurive për bashkitë e Shqipërisë.
<i>Përgjegjësi të përbashkëta</i>	
Shpërndarja e informacionit, njohurive dhe praktikave brenda NJQV-së dhe me partnerë të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të projektit, ministrive të linjës, agjencive publike, etj.	
Ndarja e të gjitha informacioneve, përvojave dhe dokumenteve përkatëse me njëri-tjetrin	
Koordinimi i aktiviteteve dhe programeve të donatorëve të ndryshëm brenda NJQV-së dhe partnerëve të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të projektit, ministrive të linjës, agjencive publike, etj.	



4 KUSHTET E PËRGJITHSHME

4.1 Monitorimi nga Projekti “Bashki të Forta”

NJQV-ja do të sigurojë që Helvetas, SDC ose një palë e tretë e autorizuar prej tyre të kenë të drejtën të monitorojnë dhe inspektojnë zbatimin dhe ecurinë e programit në çdo formë që e konsiderojnë të përshtatshme, përfshirë kontaktet personale, shqyrtimin e dokumenteve, auditimin e llogarive të projektit, etj. Helvetas rezervon të drejtën të ndërhyjë në rast të vështirësive për të përmirësuar zbatimin e programit.

4.2 Përfundimi i Projektit

Palët kanë të drejtë të ndërpresin çdo projekt për arsye të tilla si vonesa të pajustificuara, menaxhim joadekuat i projektit, cilësi të pakënaqshme, mashtrim dhe korrupsion, forcë madhore, apo arsye të tjera të justifikuara. Palët janë të gatshme të diskutojnë arsyet e vendimit me shkrim.

4.3 Modifikimet

Modifikimet dhe ndryshimet që konsiderohen se janë bërë të nevojshme gjatë zbatimit të projektit duhet t'i paraqiten projektit “Bashki të Forta” me shkrim për diskutim dhe mund të zbatohen vetëm nëse miratohen nga Helvetas Shqipëri dhe anasjelltas.

Modifikimet dhe ndryshimet që konsiderohen se janë bërë të nevojshme gjatë zbatimit të projektit duhet t'i paraqiten Bashkisë Shkodër dhe Keshillit Bashkiak me shkrim për diskutim dhe mund të zbatohen vetëm nëse miratohen nga Bashkia Shkodër dhe Keshilli Bashkiak.

4.4 Zgjidhja e konflikteve

Zgjidhja e konflikteve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e dispozitave të këtij Memorandumi Bashkëpunimi do bëhet me bisedime diplomatike ndërmjet palëve, në zbatim të ligjit nr.114/2024.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige

4.5 Numri i kopjeve të Marrëveshjes

Ky memorandum hartohet në tri kopje: dy në gjuhën shqipe dhe një në gjuhën angleze.

Ky memorandum nënshkruhet sot në _____ më ____ 2025 nga palët e mëposhtme:

Për “BASHKI TË FORTA”

Norbert Pijls

Drejtore i Projektit

Për BASHKINË SHKODËR

Benet Beci

Kryetar i Bashkisë

PËR KËSHILLIN E BASHKISË SHKODËR

Oltion Luli

Kryetar i Këshillit



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige